



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. _____ Prot

Date 14.01.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 14.01.2025

Drejtuar QuantX IT Solutions” shpk me NUIS M31904013D, me adresë: Rruga e Dibres, Njesia administrative Nr.8, kati i Pare.

Procedura e prokurimit/lotit: **PROÇEDURË E HAPUR E THJESHTUAR - mallra**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-: 26387-10-25-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: « **SMART PARKING NË KALANË E BERATIT** »

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: brenda 120 diteve nga lidhja e kontrates.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 14.01.2025

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit [Data] [Numri]_ _

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. INFORMATION BUSINESS SYSTEMS - IBS SHPK me Nipt J61820057C** Oferta e operatorit ekonomik 4 500 000 (kater milion e peseqinde mije) Lekë pa Tvsh.
- 2. QUANTX IT SOLUTIONS SHPK me Nipt M31904013D** Oferta e operatorit ekonomik 4 728 000 (kater milion e shtateqinde e njezete e tete mije) Lekë pa Tvsh.

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE**

3. **TCN SHPK** me Nipt **J61929021E** Oferta e operatorit ekonomik 4 756 146 (kater milion e shtateqinde e pesedhjetë e gjashtë mijë e njëqinde e dyzete e gjashtë) Lekë pa Tvsh.
4. **TETRA SHPK** me Nipt **K72017027P** Oferta e operatorit ekonomik 4 965 000 (kater milion e nenteqinde e gjashtedhjetë e pese mijë) Lekë pa Tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar një operator ekonomik.

TCN SHPK me Nipt **J61929021E** Oferta e operatorit ekonomik 4 756 146 (kater milion e shtateqinde e pesedhjetë e gjashtë mijë e njëqinde e dyzete e gjashtë) Lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe konformë kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të tenderit, konkretisht :

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST-ve *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikate CE për mallrat pjese e procedurës së prokurimit në veçanti për : 1) Pajisje për leshimin dhe matjen e kohës së parkimit, me ekran dhe aksesore ; 2) Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore ; 3) Pajisje bariere për kontrollin e levizjes së mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit), pasi nuk ka paraqitur në sistem asnjë certifikate të kërkuar sa me sipër.*

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6 të DST-së *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka minimalisht për periudhën muajin e fundit punonjës të profilizuar si më poshtë : 2 (dy) punonjës të certifikuar për ofrimin e suportit dhe mirëmbajtjes për sistemet e parkimit, 2 (dy) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike, nga verifikimi i formularit të vetedeklarimit të paraqitur në sistem nga operatori ekonomik rezulton se janë vetedeklaruar 8 (tete) punonjës por pa cituar secilin në çfarë shtet është i certifikuar për të kryer.*

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Për sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga ofertuesi i renditur i pari **INFORMATION BUSINESS SYSTEMS - IBS SHPK me Nipt J61820057C** me ofertë **4 500 000 (kater milion e pesëqinde mijë) Lekë pa Tvsh**, në sistemin e prokurimit elektronik paraqitjen e dokumentave provuese dhe dokumentat e tjera shoqëruese jo më vonë se 5 (pesë) ditë me qëllim verifikimin e tyre dhe vazhdimin e procedurës sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e vetëdeklarimit, dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës me nr. **6211 prot. Dt. 19.11.2024**, nga ku komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar dokumentacionin.

KVO pasi përfundoi vlerësimin, njofton njësinë për vazhdimin e procedurës në sistem.

Per kete procedure prokurimi ka paraqitur ankese prane autoritetit kontraktor e KPP operatorët ekonomik "TETRA" shpk me NUIS K72017027P, me adresë: Rruga Gjini Bue Shpata ,Pallati 2/1,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Ap.2,Njesia Bashkiake Nr.5 dhe “QuantX IT Solutions” shpk me NUIS M31904013D, me adresë: Rruga e Dibres,Njesia administrative Nr.8, kati i Pare duke kerkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK.

Me vendimin Nr.1860/2024 datë 26.12.2024 te KPP eshte vendosur:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tetra” SHPK
2. Te pranoje pjeserisht ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik“QuantX IT Solutions” shpk per arsyet e meposhteme :

Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK ka paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi por jo per zerat e kerkuara specifikisht ne piken 2.3.2 te DT, nga autoriteti kontraktor sic eshte dhe artikulli i software-it qendror per menaxhimin e qenderzuar te sistemit te parkimit .

KPP-ja konstaton se jane paraqitur certifikatat e 2 punonjesve si ”Montues i pajisjeve te sistemit te parkimit CAME PARKARE” por keta te certifikuar nuk rezultojne ne listpagesat sipas kodit perkates te profesionit te montues të pajisjeve elektronike 8213. Duke iu kthyer plotesimit te kriterit apo ajo, KPP konstaton, se kriteri eshte plotesuar pjeserisht sipas përcaktimit në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik.

Sipas konstatimeve ne vendimin e KPP Nr.1860/2024 datë 26.12.2024 autoriteti kontraktor skualifikon oferten e operatorit ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK duke renditur oferten si me poshte:

Oferta të pranuar :

1. **QUANTX IT SOLUTIONS SHPK** me Nipt **M31904013D**
2. **TETRA SHPK** me Nipt **K72017027P**

Oferta të pa pranuar :

1. **INFORMATION BUSINESS SYSTEMS - IBS SHPK** me Nipt **J61820057C**
1. **TCN SHPK** me Nipt **J61929021E**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “QuantX IT Solutions” shpk me NUIS M31904013D, me adresë: Rruga e Dibres,Njesia administrative Nr.8, kati i Pare me oferte ekonomike 4 728 000 (kater milion e shtateqinde e njezete e tete mije) Lekë pa Tvsh. [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra [_____] është është identifikuar si oferta fituese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*Bashkise Berat*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 7 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO x JO __

Nëse Po (vendimin Nr.1860/2024 datë 26.12.2024 të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)